



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.536/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ismet Jashari, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.536/2017 e datës 27.10.2017 e Ismet Jashari kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 27.10.2017 nga Ismet Jashari kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me të cilën pretendon se në vendvotimet si në: VV 1803E/1, VV 1803E/2 dhe VV 1803E/3, në VV 1823E/ 1 dhe VV 1823E/2, në VV 1817E/1 dhe VV 1817E/2, në VV 1837E/1 dhe 1837E/2, në VV 1827E/1, 1827E/2 dhe 1827E/3, në VV 1836E/1, në VV 1819/E1, 1819E/2 dhe 1819E/3, si dhe VV 1834E/1 dhe 1834E/ 2 iu janë bartur votat e tij tek një kandidat tjetër i po të njëjtit subjekt.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e

ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 536/2017 me datën 31.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli
Hasan Shala**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.